



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 29.08.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.08.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me fidane dhe drunjë dekorativ-Kontratë dy vjeçare", Nr. i prokurimit- 632-25-6592-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-093-111, **nxjerr:**

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ" e dt.26.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me fidane dhe drunjë dekorativ-Kontratë dy vjeçare", Nr. i prokurimit- 632-25-6592-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-093-111, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 22.07.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Korigjohet** DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 22.07.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korigjimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik N.T.P. "LULISHTJA BUÇAJ", me dt.26.08.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me fidane dhe drunjë dekorativ-Kontratë dy vjeçare", Nr. i prokurimit- 632-25-6592-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-093-111.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 29.08.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë pjesërisht të bazuara prandaj Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korigjimin e Dosjes së tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

